

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata e Lartë la në burg Veliajn, avokatët e huaj: Vendim kafkian, ngre pikëpyetje të forta
ADRESA	https://kohajone.com/aktualitet/gjykata-e-larte-la-ne-burg-veliajn-avokatet-e-huaj-vendi-m-kafkian-ngre-pikepyetje-te-forta/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 12:19:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 12:15:43 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1fc0d06dc0437590551a37466bbe222b27c15b8daba4d3a936fd99afd3dd701c
TEKSTI	3b84f2f440cbe324e985930a17206453e122408a100a6a11ee33a1760300f699
PAMJA	5b6c79752f5993e284d92db88ed65518d3695fe71eebc6ab7e66e16d169b7670

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	7a516683d48f27a344467d6de0be398dca0fc122b0277fa3dbafb80cf79a2a74
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c2d3424a52af1d7a5bda261c525771941165d93d82c499297c4e9de151b879e4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/7a516683d48f27a344467d6de0be398dca0fc122b0277fa3dbafb80cf79a2a74>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


Gjykata e Lartë la në burg Veliajn, avokatët e huaj: Vendim kafkian, ngre pikëpyetje të forta

AKTUALITET E PREMTE, 18 SHTATOR 2026 14:15



Pas vendimit të Gjykatës së Lartë për të lënë në paraburgim kryebashkiakun e Tiranës, ka ardhur edhe reagimi i avokatëve ndërkombëtarë të kryetarit të Bashkisë Tiranë, Erion Veliaj.

Në deklaratën e shpërndarë nga studioja ligjore amerikane Kasowitz, theksohet se vendimi i Gjykatës së Lartë vë në provë nëse kontrolli kushtetues ka fuqi praktike. "Vendimi i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë është kafkian dhe ngre një pyetje të fortë: a ka ndonjë kuptim kontrolli kushtetues në Shqipëri, nëse mangësitë kushtetuese të evidentuara nga Gjykata Kushtetuese – gjykata më e lartë në vend – nuk korrigjohen nga gjykatat më të ulëta?", thuhet në reagim.

**KOHA JONË**
Na ndiqni në YouTube

Deklarata e plotë:

Gjykata e Lartë e Shqipërisë lë në paraburgim kryebashkiakun e Tiranës, Erion Veliaj, pasi Gjykata Kushtetuese shfuqizoi vendimin e mëparshëm të Gjykatës së Lartë

Gjykata e Lartë e Shqipërisë vendosi më 15 shtator që kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj, të mbetet në paraburgim, duke lënë në fuqi vendimin e 13 marsit 2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit. Vendimi pason një vendim të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, e cila shfuqizoi vendimin e mëparshëm të Gjykatës së Lartë mbi paraburgimin e kryebashkiakut Veliaj dhe e ktheu çështjen për rishqyrtim.

Gjykata Kushtetuese konstatoi se vendimi i mëparshëm i Gjykatës së Lartë nuk kishte kryer shqyrtimin e kërkuar nga Kushtetuta për çështje të rëndësishme që lidhen me vazhdimin e paraburgimit të kryebashkiakut Veliaj, përfshirë proporcionalitetin e tij dhe pasojat kushtetuese të pengimit të kryebashkiakut të zgjedhur në mënyrë demokratike të Tiranës që të ushtrojë mandatin e besuar nga zgjedhësit e qytetit. Gjykata Kushtetuese ia ktheu çështjen Gjykatës së Lartë për shqyrtim të mëtejshëm.

Kryebashkiaku Veliaj ndodhet në paraburgim që prej 10 shkurtit 2025 – më shumë se 19 muaj – dhe vazhdon të jetë kryebashkiaku i zgjedhur i Tiranës. Në një vendim të veçantë vitin e kaluar, Gjykata Kushtetuese shpalli të pavlefshme një përpjekje për ta shkarkuar nga detyra për shkak të mungesës së tij të pavullnetshme gjatë kohës që ndodhej në paraburgim.

Daniel J. Fetterman, partner në Kasowitz LLP dhe avokati kryesor ndërkombëtar i kryebashkiakut Veliaj, deklaroi:

LAJMET KRYESORE



Rama fton magistratët: Të ulemi në një tryezë pune, kërkojmë një zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë për pagat



Presidenti Begaj dekreton ligjin për rritjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve



BE kërkon kufizime më të repta për rrjetet sociale



Rama në Kuvend: Gjykatësit s'mund të kenë pagat më të larta në vend. KLGJ e KLP kanë dështuar



Berisha hedh dyshimin e madh: A e pagoi Hashim Thaçi projektin për ndryshimin e kufijve?

TË PËRZGJEDHURA



Hamilton mohon kategorikisht: "S'kam kërkuar ndryshime stafi te Ferrari"



Klopp thërret 44 lojtarë për Gjermaninë: "Krenaria kombëtare të mos u besohet njerëzve të gabuar..."



Berisha hedh dyshimin e madh: A e pagoi Hashim Thaçi projektin për ndryshimin e kufijve?



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve

MË TË LEXUARAT

"Vendimi i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë është kafkian dhe ngre një pyetje të fortë: a ka ndonjë kuptim kontrolli kushtetues në Shqipëri, nëse mangësitë kushtetuese të evidentuara nga Gjykata Kushtetuese – gjykata më e lartë në vend – nuk korrigjohen nga gjykatat më të ulëta?

"Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë shfuqizoi vendimin e mëparshëm të Gjykatës së Lartë dhe e riktheu këtë çështje për shqyrtim, sepse nuk ishte kryer shqyrtimi thelbësor i kërkuar nga Kushtetuta lidhur me proporcionalitetin e paraburgimit të kryebashkiakut Veliaj, masat më pak kufizuese dhe pasojat e pengimit të kryebashkiakut të zgjedhur të Tiranës që të ushtronte mandatin e dhënë nga qytetarët e Tiranës.

"Kryebashkiaku Veliaj ka kaluar tashmë më shumë se 19 muaj në paraburgim, pa asnjë gjykim apo dënim. Të drejtat kushtetuese nuk mund të ekzistojnë vetëm në letër dhe kontrolli kushtetues nuk mund të shndërrohet në një ushtrim pa pasoja praktike. Shteti i së drejtës nuk varet thjesht nga nxjerrja e vendimeve prej gjykatave kushtetuese, por edhe nga zbatimi kuptimplotë i këtyre vendimeve.

"Prandaj, kjo çështje ngre një pikëpyetje institucionale shumë më të gjerë: nëse sistemi i drejtësisë në Shqipëri e respekton shtetin e së drejtës kur mbrojtjet kushtetuese kërkojnë një drejtim tjetër dhe nëse vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë ndonjë kuptim praktik.

"Institucionet e Shqipërisë kanë ende mundësinë të dëshmojnë se garancitë kushtetuese janë të zbatueshme dhe jo thjesht aspirata. Ne do të vazhdojmë të ndjekim çdo rrugë ligjore në dispozicion të kryebashkiakut Veliaj dhe të këmbëngulim për një proces në përputhje me këto parime."

Njoftimi publik i Gjykatës së Lartë, i datës 15 shtator, bën të ditur se Gjykata la në fuqi vendimin e 13 marsit 2025 të Gjykatës së Posaçme të Apelit. Njoftimi nuk përmban ende arsyetimin e plotë me shkrim të Gjykatës dhe thekson se vendimi i arsyetuar do t'u komunikohet palëve në përputhje me procedurat e Gjykatës.

Çështjet që lidhen me paraburgimin e kryebashkiakut Veliaj lindin në një kontekst më të gjerë procedural. Kasoëitz ka raportuar më parë se informacionet e bëra publike me urdhër gjykatë tregonin se hetimi i SPAK-ut dukej se kishte nisur nga kallëzime anonime që u atribuoheshin "Nesti Agonit" dhe "Nasta Pëllumbit", asnjëri prej të cilëve nuk rezultonte në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të Shqipërisë. Kryebashkiaku Veliaj ka paraqitur gjithashtu një kundërshtim të veçantë lidhur me faktin nëse prokurori kryesor Ols Dado i përmbushte kërkesat ligjore që rregullonin emërimin e tij. Këto çështje janë të ndara nga vendimi i Gjykatës së Lartë i datës 15 shtator mbi paraburgimin.

MË SHUMË NGA AKTUALITETI



Bashkia e Tiranës kontrollon ndaj agjencive funerale, masa për reklama...

Rrugorja e Tiranës: 7 të arrestuar dhe mbi 6800 gjoba në 72 orë

Nis protesta në Prishtinë kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së nga...



Rama fton magjistratët: Të ulemi në një tryezë pune, kërkojmë një zgj...



Sherri i dhunshëm në Sarandë. Dy vëllezërit plagosen brenda berberhan...



Presidenti Begaj dekreton ligjin për rritjen e pagave të gjyqtarëve d...

LAJMET E FUNDIT



Gjykata e Lartë la në burg Veliain, avokatët e huaj: Vendim kaffkian, ngre pikëpyetje të forta

1 MINUTË MË PARË



U votua dhe u dekretua me urgjencë, botohet në Fletoren Zyrtare ligji për rritjen e pagave të magjistrave

1 ORË E 6 MINUTA MË PARË

Bashkia e Tiranës kontrolle ndaj agjencive funerale, masa për reklamat dhe ekspozimin në zonat e banuara

15 MINUTA MË PARË



Nis protesta në Prishtinë kundër dënimit të ish-krerëve të UÇK-së nga Gjykata Speciale

1 ORË E 30 MINUTA MË PARË

Rrugorja e Tiranës: 7 të arrestuar dhe mbi 6800 gjoba në 72 orë

27 MINUTA MË PARË



Rama fton magjistratët: Të ulemi në një tryezë pune, kërkojmë një zgjidhje të qëndrueshme afatgjatë për pagat

1 ORË E 31 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Samë Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: **Nikoll LESI**

KRYEREDAKTOR: **Daniel MUÇAKU**

ZV/KRYEREDAKTOR: **Redjon SHTYLLA**

BORDI: **Elsa KAMBERI**, KRYETARE

NIPT: **J71425013C**



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA



© 2024 KOHA JONË. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.